

RAPORTI I PUNËS **PËR VITIN** **2022**

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
PËR NDËRMARRJEN.....	4
Vizioni i Kompanisë	5
Misioni i Kompanisë	5
Qëllimet.....	5
Objektivat e ndërmarrjes	5
Korniza Ligjore	5
Strategjia e ndërmarrjes	6
Shërbimet që ofrojmë	6
Analiza e tregut	6
Analiza Swot	7
Burimet njerëzore	9
Marketingu	13
Plani i prokurimit	14
KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE	16
BORDI I DREJTORËVE	16
KRYESHEFI	17
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	20
DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT DHE DISTRIBUIMIT....	21
DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	23
DEPARTAMENTI I PRODHIMIT	31
Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes.....	32
Informimi dhe avokimi.....	32



Akronimet dhe shkurtesat

NPL	Ndërmarrje publike lokale
KQ	Kuzhina Qendrore
KK	Kuvendi Komunal
KP	Komuna e Prishtinës
KA	Komisioni i Aksionarëve
KB	Kryesuesi i Bordit
DB	Drejtorët e Bordit
KAB	Komisioni i Auditimit të Brendshëm
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
IP	Institucione Parashkollore
QS	Qendra Sociale



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore sh.a. është themeluar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Prishtinës në vitin 2019. Megjithatë aktivitetin e saj të punës dhe financiar e ka filluar në mënyrë të pavarur nga Komuna e Prishtinës nga 1 janar 2022. Deri në këtë kohë të gjitha proceset brenda ndërmarrjes janë realizuar nga Komuna e Prishtinës, duke filluar nga pagat, furnizimit, investimet dhe gjera të tjera të nevojshme për ndërmarrjen.

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 31 paragrafi 31.3, ndërmarrja obligohet që të përgatisë dhe dorëzoj Bordit të Drejtorëve një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, e në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmeria e përgjithshme në realizimin e caceve të vendosura në Planin e Biznesit.

Sipas të njëjtit ligj, neni 8, paragrafi 8.2 Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të NP-së përkatëse Lokale në interes të Komunës.

Raporti Vjetor është dokument që reflekton zhvillimin financiar të ndërmarrjes, përmes të cilin përcaktohen objektivat dhe harta e zbatimit të projekteve që ndikojnë në krijimin e stabilitetit financiar të ndërmarrjes. Ky raport përmbledhe në vete atë që bazuar në nenin 30 të Ligjit për ndërmarrje publike, deri më 31 Tetor të çdo viti kalendarik, çdo ndërmarrje publike, pavarësisht, a i takon nivelit lokal apo qendror është e obliguar që të përgatisin Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik.

Raporti i hartuar në vijim analizon së paku, çështjet si në vijim:

- një përshkrim të synimeve afariste dhe financiare të cilat ëshë synuar të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre;
- mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve;
- përcaktimin e shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrës për financimin e shpenzimeve;
- veprimet të cilat janë ndërmarr për arritjen e synimeve; dhe
- detyrimet e ndërmarrjes karshi konsumatorëve dhe publikut.
-

Raporti vjetor i NPL Kuzhina Qendrore sh.a në vete përmban informata të thukëta sa i përket ndërmarrjes. Raporti flet për misionin dhe vizionin e saj si dhe paraqet objektivat zhvillimore për periudhën në vijim. Raporti nuk le pa përmendur edhe zhvillimet e brendshme në ndërmarrje, veçmas tek respektimi i Kontratës në shtëpi më Komunën e Prishtinës për përgatitjen, dërgimin

dhe shërbimin e shujtave për Institucionet parashkollore dhe për familjet më gjendje të rend sociale.

Raporti përfshinë punën e të gjitha departamenteve të ndërmarrjes dhe aty paraqiten të gjitha veprimet që janë bërë. Jep një pasqyrë e aktiviteteve që kanë ndodhur në administratën e ndërmarrjes. Shpërfaqe edhe lëvizjet financiare që pritet të bëhen në ndërmarrje në vitin vijues. Aty paraqitet tendenca pozitive e rritjes së ndërmarrjes.

Përshkruhet aktiviteti i shtuar i Zyrës së Prokurimit. Sa i përket buxhetit të ndërmarrjes, Raporti tregon se ka një trend pozitiv të të hyrave, çka do i siguroj ndërmarrjes një stabilitet solid në kryerjen e të gjitha obligimeve të mëhershme apo të krijuara gjatë kësaj periudhe.

Prezanton qëllimin e ndërmarrjes që të jetë një ndërmarrje publike e suksesshme, e qëndrueshme financiarisht, me synim të zgjerimit të investimeve të reja kapitale në kapacitetet prodhuese e shërbyese në gastronomi, investimet kapitale në industritë ndërlidhëse prodhuese (ushqimore), të arrij kapacitetin maksimal prodhues në fushën e industrisë ushqimore dhe të bëhet faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik lokal.

Raporti vjetori financiar për periudhën Janar – Dhjetor 2022 paraqet gjendjen financiar të ndërmarrjes, shpreh dhe prezanton performancën e të hyrave dhe të shpenzimeve, pasqyron gjendjen financiare të ndërmarrje në mbyllje të vitit si dhe afarizmin biznesor të ndërmarrjes që do të thotë pasqyron fitimin ose humbjen e realizuar gjatë vitit 2022.

Duke qenë të vetëdijshëm që viti 2022 ka qenë vit jo stabil sa i përket inflacionit, konkludojmë që ndërmarrja ka arritur që me sukses të menaxhoj efektin e inflacionit dhe ndikimin e tij në zërat financiar të saj.

Risia e vitit 2022 ishte nisja e aktivitetit të përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit për sektorin privat, i cili si projekt ka nisur në gjysmën e dytë të vitit dhe që ka rezultuar më të hyra shtesë për ndërmarrjen, të cilat janë paraqitur në kapitujt e mëposhtëm.

Analiza e tregut e ndërmarrjes është fokusuar në krijimin e një produkti cilësor të pranueshëm dhe të përballueshëm financiarisht nga qytetari ynë. Në këtë pikë të gjitha planifikimet dhe orientimet tona janë që të jemi adresa e parë e çdo qytetari.

Me respekt,
Asdren Osaj, **Kryeshf ekzekutiv.**

PËR NDËRMARRJEN

Ndërmarrja Publike “Kuzhina Qendrore” sh.a. është themeluar me datën 5 Qershor 2019 nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Kuzhina Qendrore aktualisht furnizon gjithsej 16 çerdhe, prej të cilave 8 janë publike dhe 8 me bazë në komunitet

Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndërtuar bazuar në përgjegjësit ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. Ndërmarrja udhëhiqet sipas kësaj hierarkie: Komisioni Komuna i Aksionare, që emërohet nga Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës, Bordi i Drejtorëve që emërohen përmes një procesi rekrutues nga Komisioni Komunal i Aksionarëve si dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes që përmes një procesi rekrutues emërohet nga Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes. Kjo është struktura e nivelit të lartë që menaxhon me ndërmarrjen.

Kuzhina Qendrore aktualisht furnizon gjithsej 16 çerdhe, prej të cilave 8 janë publike dhe 8 me bazë në komunitet (Lista në Anex 1). Bazuar në kapacitetet aktuale, ndërmarrja mundet në çdo kohë të rris kapacitetin e shujtave për këtë kategori të shoqërisë nëse diçka e tillë kërkohet.

Aktualisht, ndërmarrja përgatitë 3 shujta në ditë për afërsisht 2490 fëmijë prej të cilëve 1651 të çerdheve publike dhe 839 fëmijë nga çerdhet me bazë në komunitet si dhe 500 shujta në ditë për 2 Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane). Gjatë vitit të parë të projeksioneve, numri i fëmijëve në çerdhe publike do qëndroj i njëjtë përgjatë periudhës 2021-2022.

Vizioni i Kompanisë

N.P.L “Kuzhina Qendrore“, sh.a. ka vizion të bëhet sinonim i ushqimit të shëndetshëm në Komunën e Prishtinës, dhe të njihet si shembull i përsosmërisë në ofrimin e produkteve ushqimore për fëmijët, bizneset dhe qytetaret e saj, si dhe duke aplikuar praktika më të mira Evropiane.

Misioni i Kompanisë

Misioni ynë është të vazhdojmë angazhimin për ushqim të shëndetshëm, me cilësi, standarde të larta, shije të mirë dhe çmim të volitshëm.

Qëllimet

Kuzhina Qendrore ka për qëllim që të jetë një ndërmarrje publike e suksesshme, e qëndrueshme financiarisht, me synim të zgjerimit të investimeve të reja kapitale në kapacitetet prodhuese e shërbyese në gastronomi, investimet kapitale në industritë ndërlidhëse prodhuese (ushqimore), të arrij kapacitetin maksimal prodhues në fushën e industrisë ushqimore dhe të bëhet faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik lokal.

Objektivat e ndërmarrjes

Ndërmarrja publike lokale “Kuzhina Qendrore” sh.a. brenda funksionimit të saj dhe brenda detyrave primare, që ia përcakton fushë veprimtari që ushtron por edhe aktet ligjore, ka analizuar dhe hartuar disa caqe afariste të cilat i ka shndërruar në objektiva dhe aktivitete:

Shtimi i kapaciteteve të furnizimit të Institucioneve Parashkollore, pavarësisht natyrës, me ushqim të freskët, cilësor dhe të bollshëm;

Prezantimi dhe ofrimi i ushqimit bazuar në rekomandimet e Komisionit të Menysë, i përberë nga nutricionist, përfaqësuesve të prindërve dhe institucioneve parashkollore tek institucionet tjera parashkollore në kryeqytet do të jetë aktiviteti primar për arritjen e objektivit të parë.

Shtimi i kapaciteteve prodhuese përmes investimeve të reja kapitale;

Investimi në ndarje të kuzhinës dhe sistemit të ventilimit si dhe hartimi i projektit për aneksin e kuzhinës, janë disa nga format me anë të së cilave ndërmarrja synon të shtoj kapacitetin prodhues. Këto ndryshime parashihet që ta rrisin nivelin e prodhimit, të lehtësojnë punën e kuzhinës si dhe të kursejnë kohën.

Zgjerimi i bashkëpunimit me institucione publike dhe institucione tjera relevante për furnizime me shujta ditore;

Me zgjerimin e kapacitetit prodhues u shtua mundësia për bashkëpunim me institucione tjera duke prezantuar menynë dhe duke krijuar kushte për ofrim të ushqimit në baza ditore.

Zgjerimi i bashkëpunimit me bizneset private për furnizim të rregullt me shujta ditore.

Gjatë vitit 2022, siç e përmendem edhe me lartë është nisja e aktivitetit për përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit për sektorin privat, i cili si projekt ka nisur në gjysmën e dytë të vitit dhe që ka rezultuar më të hyra shtesë për ndërmarrjen, të cilat janë paraqitur në kapitujt e mëposhtëm

Përmbushja e këtyre objektivave është bërë me angazhim maksimal nga departamentet përkatëse, ku synim parësorë ishte maksimizimi i fitimit përmes shërbimeve profesionale dhe cilësore.

Korniza Ligjore

Ndërmarrja Publike Lokal “Kuzhina Qendrore” sh.a., është themeluar bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike. Është themeluar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, ku Komuna e Prishtinës është aksionar i 100%. Ndërmarrja fushë veprimtarinë e vet e bazon në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si dhe në aktet e brendshme të nxjerra nga Aksionarët dhe Bordi.

Gjatë periudhës raportuese, ndërmarrja ka arritur që t'i plotësoj dhe ndryshoj disa rregullore, që janë të domosdoshme për funksionalitetin e punëve në ndërmarrje. Rregulloret e përmendura në këtë raport janë përpiluar në bashkëpunim dhe me ndihmën e drejtorëve të Bordit Drejtues të cilat kanë dhënë mundin e tyre për të përfunduar këto dokumente bazike për funksionimin institucional të ndërmarrjes

Strategjia e ndërmarrjes

Viti 2022 ishte vit i konsolidimit të ndërmarrjes si rezultat i kësaj të gjitha projektet janë zhvilluar në bazë të prioritetit ad-hoc. Është hartuar një plan i prokurimit në bazë të së cilit kemi funksionuar por nuk jemi kufizuar me të, sepse ka qenë e domosdoshme të zhvillohen edhe projekte të cilat nuk janë të përfshira, por funksionimi i ndërmarrjes ka qenë i pamundur pa to. Si rezultat i kësaj ndërmarrja parasheh hartimin e strategjisë, e cila do të përfundoj brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023. Kjo strategji merr kohe pasi që do të jetë tre vjeçare andaj kërkon detaje dhe angazhim më të madh, meqenëse nga kjo varet e gjithë puna e ndërmarrjes.

Shërbimet që ofrojmë

Portofoli i shërbimeve të ndërmarrjes të cilat aktualisht ia afrojmë klientëve tanë është i ndryshëm dhe përshin një numër të konsideruar të shërbimeve.

- Përgatitja, transporti dhe shërbimi i tre vakteve për Institucionet Parashkollore Publike
- Përgatitja, transporti dhe shërbimi i tre vakteve për Institucionet Parashkollore me bazë në Komunitet;
- Përgatitja, transporti dhe shërbimi i një vakti për familjet në gjendje të rend sociale;
- Përgatitja dhe transporti i vakteve me porosit nga qytetarët dhe bizneset.

Produktet që ofron ndërmarrja ndahen në dy kategori: Shujta për fëmijë dhe shujta për të rritur. Fëmijët gëzojnë meny katër (4) javore e cila ju ofrohet tri (3) herë në ditë. Këto racione përmbajnë drithëra, mish, bylmet, perime dhe fruta. Ndërmarrja nga mesi i vitit 2022 ka filluar shitjen edhe në tregun privat, ku trendi i shtijës ka pasur rritje mujore të kënaqshme. Produktet që shërbehen në këtë sektor përmbajnë gjella ditore, pasta, ushqime të shpejta, lloje të ndryshme të rizotove dhe ushqime tradicionale.

Analiza e tregut

Gastronomia, sektori ku bënë pjesë me shërbime ndërmarrja në vitet e fundit ka shënuar një trend sa zhvillues po aq edhe modernizues, ndoshta të shtyre edhe nga nevoja për t'ju përgjigjur kërkesave të klientëve dhe ndryshimeve të rrepta ekonomike që kanë ndodhur në dy tre vitet e fundit.

Megjithatë, Kosova është shteti më i ri në Evropë me popullsinë më të re dhe me gjithë potencialin e fuqisë punëtore, rritja ekonomike e Kosovës nuk është në gjendje që të krijojë vende pune për tërë forcën aktive të punës që mbetet si resurs i pashfrytëzuar i ekonomisë sonë. Bazuar në përlogaritjet zyrtare, popullsia e Kosovës në vitin 2017 ishte 1,793,467 me 905,364 meshkuj dhe 888,103 femra. Personat e moshuar mbi 65 vjeç përlogaritet të jenë 209.785 ku 100.264 janë meshkuj dhe 109.521 femra. Numri i të punësuarve brenda diapazonit të moshës 15 dhe 64 është 341.610 si dhe 142.550 të papunë. Sidoqoftë, punësimi i të rinjve në moshën 15 dhe 24 vjeç është 33,113 dhe papunësia në grup moshën e njëjtë është 40,447.

Sa i përket përbërjes sektoriale të aktivitetit të punësimit, ndërtimtaria, arsimi dhe prodhimtaria përmbajnë më shumë se gjysmën e të punësuarve. Punësimi më i ulët në total ka të bëjë me aktivitetet e pronës ndërsa punësimi maksimal sipas aktivitetit është i përqendruar në tregtinë me pakicë e me shumicë.

Bazuar në këtë gjendje, analiza e tregut e ndërmarrjes është fokusuar në krijimin e një produkti cilësor të pranueshëm dhe të përballueshëm financiarisht nga qytetari ynë. Në këtë pikë të gjitha planifikimet dhe orientimet tona janë që të jemi adresa e parë e çdo qytetari.

Megjithatë në aspektin sektorial ndërmarrja zhvillon aktivitetin e saj brenda një tregu mjaftë të zhvilluar dhe konkurrues në fushën e gastronomisë. Mbi këtë bazë për të ju përshtatur sfidave të tregut dhe përballjes me konkurrencën, ndërmarrja objektiv ka investimin në cilësi, shërbim dhe pajisë që lehtësojnë qasjen tek konsumatori.

Karakteristike e ndërmarrjes është, mundësia për t'iu përgjigjur shpejt kërkesave në rritje për shërbimin e produkteve ushqimore për përdorim të menjëhershëm. Gatishmëria për të ju përshtatur shpejt kërkesave të klientëve sa i përket llojeve të ushqimeve dhe menysë që propozojë.

Planifikimet e ndërmarrjes mbështeten kryesisht në qëllimet e zhvillimit të sektorit të gastronomisë, krijimi i vendeve të punës, rritja e shërbimeve dhe cilësisë si dhe shtrirja tek grupet me specifike të shoqërisë, siç është familja dhe biznesi.

Investime në përmirësimin e infrastrukturës së ndërmarrjes, investimi në modernizimin e pajisjeve, krijimi i hapësirës së nevojshme dhe të sigurt të punës për të gjithë të angazhuarit në ndërmarrje, është një ogur i mirë që i siguron ndërmarrjes një vend qenësor në tregun kosovar.

Analiza Swot

Kjo analize ngërthen në vete faktorë të cilët përbejnë ambientin e brendshëm dhe të jashtëm të organizimit të punës. Kjo paraqet një kornizë që grupon faktorët në raport me konkurrentet, segmentin e tregut ose tregun në përgjithësi. Me anë të kësaj behët vlerësimi faktik për njëpërdhë të caktuar. Në rastin tonë një parashikim të përafërt të së ardhmes. Faktorët të cilët kanë ndikim pozitiv në veprimtarin e ndërmarrjes paraqiten si përparësi të cilat janë listuar me poshtë.

Përparësitë

- Infrastrukturë të qëndrueshme të prodhimit të produkteve ushqimore;
- Kushte dhe pajisje të përshtatshme të përgatitjes së ushqimit sipas standardeve me kapacitet aktual;
- Departament të organizuar të prodhimit dhe distribuimit të ushqimit;
- Ofrimi i ushqimit cilësor me meny të pasur sipas udhëzimeve të nutricionistëve për Institucionet Parashkollore dhe sektorin privat

Faktorët e jashtëm si zhvillimet teknologjike të cilat gjenerojnë mundësi për zhvillim, listohen si mundësi. Ndërmarrja këto avancime teknologjike synon t'i adaptoj në procesin e shtijës së produkteve online. Mundësi tjera të cilat ndërmarrja mund të përfitojë në raport me konkurrencën janë këto:

Mundësitë

- Shtimi i produkteve të reja ushqimore, begatimi i menyre dhe zgjerimi i prodhimtarisë në fushën e pastërisë .
- Potencial për rritjen e të hyrave të ndërmarrjes
- Shitja e produkteve ushqimore on-line
- Potencial për të zgjeruar rrjetin e prodhimit të produkteve ushqimore edhe në institucionet tjera
- Bashkëpunimi dhe zgjerimi me institucionet private parashkollore (çerdhet)
- Bashkëpunim me bizneset për ofrim të shujtave dhe ushqimeve cilësore në vende punishte.

Faktorët negativë të cilët burojnë nga brenda ndërmarrjes paraqiten kryesisht në mungesën e financimit të investimeve të mëdha kapitale. Tendencia për të qëndruar në hap me zhvillimet teknologjike ballafaqohet me mungesën e njohurive nga ana e stafit të ndërmarrjes. Si zgjidhje për këtë dobësi, në vitin e ardhshëm planifikohet zbatimi i disa llojeve të trajnimeve për departamente të caktuara të ndërmarrjes.

Analiza e tregut

- Mungesa e njohurisë për përdorimin e pajisjeve të kohës për përgatitjen e ushqimit;
- Mungesa e trajnimeve që do të ndikonin në zhvillimin e vazhdueshëm profesional.
- Kapacitete të limituara financiare për investime kapitale dhe strategjike në ndërmarrje;
- Mungesa e laboratoriumit për kontrollin e cilësisë së ushqimit

Ndryshimi i kushteve të tregut bart me vete rreziqe të cilat mund të krijojnë probleme të paparashikuara. Rast evident në vitin 2022, ishin krizat e ndryshme nga ajo e çmimeve që u përcjell me inflacion, rritja e çmimeve të naftës dhe kriza e energjisë elektrike. Këto lloje rreziqesh krijojnë kosto financiare të paplanifikuara dhe humbje nga mos shfrytëzimi i plotë i potencialit prodhues.

Rreziqet

- Mos furnizimi i rregullt me furnizim të energjisë elektrike,
- Problemet teknike;
- Konkurrenca jo lojale

Analiza e këtyre faktorëve nuk është e pandryshueshme, hartimi dhe kontributi i tyre mund të jete pozitiv për një kohë dhe rrezik në një periudhë tjetër, apo respektivisht mundësi për një biznes dhe dobësi për një tjetër. Ato nuk mund të qëndrojnë si te indikator te pavarur por duhet trajtuar gjithmonë ne periudhën e caktuar dhe pozitën e ndërmarrjes në treg.

Burimet njerëzore

Ndërmarrja ka trashëguar një staf, ku shumica prej tyre kanë përgatitje të mesme shkollore. Përveç kësaj stafi është në moshë të shtyrë. Aktualisht në ndërmarrje janë 66 të punësuar, përfshirë Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin Komunal të Aksionareve.

Është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri. Në këtë pikë orientimet tona janë organizimi i trajnimeve për stafit të ndërmarrjes.

Ndërkohë gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar kontratat e reja të punës, bazuar në rregullativen e re të ndërmarrjes. Mosha mesatare e punëtorëve është 40.3 vjeç.

Evidenca e nivelit të shkollimit të stafit të N.P.L Kuzhina Qendrore Sh. A

Shkollë Fillore	4	6.06%
Shkollë e Mesme	42	63.63%
Shkollim i lartë Universitar	20	30.30%
Total	66	100%

Punësimet dhe trajnimeve të stafit për vitin 2022

Viti 2022 ishte vit i funksionalizimit të plotë të ndërmarrjes dhe rrjedhimisht pavarësimit të saj nga Komuna e Prishtinës. Duke u nisur mbi këtë, në fillim të vitit, duke u bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit për Transferimin e punonjësve nga Komuna e Prishtinës në NPL Kuzhina Qendrore, është përfunduar i terë procesi i transferimit të këtyre punëtorëve si dhe janë hapur dy konkurseve për plotësimin e vendeve të punës, për vendet të cilat ishin të lira dhe nuk plotësoheshin nga kjo marrëveshje. Në këtë planifikim ishin të përfshira plotësime të domosdoshme në pozitat aktuale si dhe pozita të reja të përshtatura sipas nevojave të ndërmarrjes e që ishin në harmoni me Planin e Biznesit 2022. Punësimet u bënë në bazë të kërkesave të departamenteve. Brenda këtyre punësimeve u dhamë përparësi personave të kualifikuar dhe respektuam aspektin të barazisë gjinore.

Trajnimet

Duke qenë vit i parë i konsolidimit financiar ndërmarrja u fokusuar në hulumtimin e nevojave për trajnimin e stafit. Qëllimi i trajnimeve është ngritja e kapaciteteve brenda stafit ekzistues dhe përshtatja e tyre me nevojat e ndërmarrjes por edhe të tregut ku afarojmë. Duke qenë se ishim në hapat e parë të zhvillimit tonë dhe objektiv e jona zhvillimore ishte prezenca jonë në tregun privat, duke mos lene anash edhe sektorin publik, ne u orientuam në trajnimin e stafit në fushën e komunikimit institucional

Në mënyrë që të jemi në gjendje të realizojmë objektivat e lartpërmendura gjatë vitit 2022, ne i kemi kategorizuar resurset e nevojshme që duhet siguruar me kohë. Këto resurse i kemi ndarë në tri kategori dhe atë:

- Resurse teknologjike;
- Resurse njerëzore dhe
- Resurse financiare
- Resurset teknologjike

Resurset teknologjike të cilat janë të nevojshme për realizimin e objektivave të lartpërmendura. Prioritet është zhvillimi i teknologjisë në përpunim e ushqimit, shpërndarjes dhe porosisë. Në këtë pikë do të investohet në teknologji të re dhe softver që mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të ndërmarrjes.

Resurset njerëzore

Në mënyrë që të realizojmë objektivat e lartcekura në kemi planifikuar që gjatë vitit 2023 t'i plotësojmë nevojat tona me resurse njerëzore të nevojshme, duke bërë punësime të reja të cilat do të jenë të shpërndara në fusha të ndryshme të ndërmarrjes dhe të punësuarit të jenë kryesisht të rinj në moshë dhe me kualifikim superior.

Resurset e nevojshme financiare për realizimin e objektivave të Planit të punës janë strukturuar në mënyrë që të paraqitet burimi i krijimit të këtyre resurseve si dhe shpërndarja e tyre sipas linjave buxhetore në mënyrë që ta kemi të qartë destinimin e këtyre resurseve sipas Planit të Biznesit në përgjithësi ndryshojnë nga parashikimet fillestare.

Kur jemi të fusha e resurseve njerëzore, viti 2022 ishte vit sfidues për ndërmarrjen por edhe për të punësuarit, meqë kishim lëvizje të mëdha të inflacionit, që rrjedhimisht u reflektuar edhe në gjendjen e ndërmarrjes. Për të evituar efektin negativ, ndërmarrja gjatë vitit 2022, ka bërë lëvizje në nivelin e pagave për të gjithë stafin tre here brenda periudhës raportuese, duke bërë që paga mesatare të lëviz nga 397.58 në 496.60 euro në fund të vitit....

Pozitat	Numri 2021	Numri 2022
Kuzhinier	8	8
Servituese	25	25
Mirëmbajtëse higjienë dhe enëlarëse	3	5
Administratë (tjerë)	7	13
Shofer	3	5
Punëtor teknik	3	3
Drejtore të Bordit	4	4
Aksionar	2	3

Tabel 1. Numri i të punësuarve gjatë vitit 2022 krahasuar me 2021

¹ Nga 55 në 66 ka lëvizur numri i të punësuarve gjatë vitit raportues

Krahasimi i pagës mesatare ndërmjet vitit 2021 dhe 2022




Tabela 2 Të ardhurat e punëtorëve (paga mesatare 2021/2022)

Marketingu

Promovimi dhe brendimi

Ndryshimi i logos se ndërmarrjes ose ridizajnimi i logos ekzistuese ishte qëllimi parësorë. Një logo e re me ikone dhe shkrim unifikues bënë freskimin e prezantimit të ndërmarrjes në treg. Ky ndryshim do të shoqërohet me aktivitete promovuese në të cilin prezantohet logo e re dhe prezantimi i produkteve që ndërmarrja ofron.

Arsye pse na nevojitej brendim i llogos dhe të gjitha aktiviteteve promovuese është se karakteristikat e produkteve që ofrohen nga ndërmarrja dallojnë. Menyja e fëmijëve është e ndryshme nga menyja e shujtave që Kuzhina ju ofron kërkesave në tregun privat. Si dhe ushqimi i fëmijëve që dërgohet nëpër institucione parashkollore është në paketim me shumicë- “termosa”.

Qëllimi i ndërmarrjes ishte që ky paketim të përmirësohet duke u avancuar, në kuptimin e paraqitjes së tij. Me blerjen investive- printerin e etiketave, ndërmarrja synoj shumë-përdorimin e tij. Produkti i standardizuar do të përcillet me paketim përkatës, mbështjellës dhe tikete në paketim e cila do të shpjegoj përmbajtjen e produktit në vlera ushqyese (kalori, energji, yndyre dhe sheqer, etj).

Praktike e vazhdueshme e ndërmarrjes është marrja e inputeve nga klientela dhe përmirësimi i shërbimeve në vazhdimësi. Shtimi dhe pasurimi i menysë si rezultat i kërkesave të klientëve ishte parim primar i ndërmarrjes. Për t'i kuptuar më mirë kërkesat e klientëve, u organizuan grupe të fokusit me përfaqësuese të ndryshëm nga tregu.

Ndërkohë mbetet synim i ndërmarrjes për vitin e ardhshëm arritja e marrëveshjeve jo vetëm me klientë të biznesit por edhe individ apo familje. Plani “Dreka / Darka në shtëpi” i cili u planifikua gjatë 2022, target i ka familjet të cilat për shkak të angazhimeve ditore dhe në pamundësi të përgatitjes së drekës apo darkës, këtë shërbim ta marrin pas orës 16:00 nga Kuzhina Qendrore. Formë tjetër e promovimit të ndërmarrjes do të jetë edhe pjesëmarrja në panairë vendore dhe ndërkombëtare.

Prezantimi i menysë së re të fëmijëve në institucionet parashkollore tjera private ishte një prej aktiviteteve që u zhvillua gjatë fundit të vitit. Përparësia krahasueses e kësaj menyje është vlera ushqyese e saj me një çmim të arsyeshëm. Ky prezantim u bë përmes kontakteve të drejtpërdrejta ose në formë të promovimit elektronik.

Plani i prokurimit

Kuzhina Qendrore vitin 2022 e kishte vit të konsolidimit dhe projektet janë zhvilluar kryesisht në bazë të nevojave të dala aty për aty ose për të përmirësuar dhe lehtësuar punën e Kuzhinës.

Procedurat e prokurimit	Shuma (€)
Furnizim dhe instalim i kamerave	968.65
Furnizim dhe instalim i sistemit të menaxhimit të hyrje-daljeve	350.00
Furnizim dhe montim i dyerve	3,558.60
Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (PC)	1,660.00
Furnizim me program të kontabilitetit	944.00
Krijim, dizajnimi dhe mirëmbajtje e ueb faqes	977.00
Furnizim me materiale higjienikë	14,166.40
Furnizim me pemë dhe perime	67,482.42
Instalimi i laurës automatike	1,530.00
Furnizimi dhe montimi i veshjeve te mureve për zyre	4,400.00
Furnizimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	595.00
Furnizim me printer fiskal	670
Furnizim me pajisje te reja për nevojat e Kuzhinës Qendrore	6,552.94
Furnizim me artikuj ushqimor	25,815.90
Furnizim me pajisje të teknologjisë informative	7,880
Furnizim me peme dhe perime	81,999
Furnizim me mish	97,964
Furnizim me bylmet	100,576.80
Furnizim me lexues barkodi dhe printer për etiketa	855.00
Furnizim me paketime ushqimore	1,987.80
Furnizimi dhe montimi i strehës	2,448.00
Furnizim me veturë-furgon	19,850
Sigurim dhe regjistrim i veturës	235
Servisim i Gjeneratorit	3,500

Përcjellja e zbatimit të Planit të Biznesit 2022

Në mënyrë që të kishim një përcjellje në kohë të duhur për veprim të rezultateve të këtij plani në përdorem disa mekanizma matës për secilin objektiv kryesisht në këto pika:

- Monitorimi i realizimit të të hyrave dhe krijimit të shpenzimeve;
- Monitorimi i rritjes/rënies së kërkesave;
- Monitorimi i rritjes/rënies së ofertave;
- Monitorimi rreth krijimit të tregjeve të reja;
- Monitorimi i përfitimit të klientëve të rinj;
- Monitorimi i mbajtjes së klientëve ekzistues dhe potencialë;
- Monitorimi i kënaqshmërisë së klientëve tanë me shërbimet e ofruara;
- Monitorimi i pozicionit tonë ndaj konkurrentëve tanë;
- Monitorimi i realizimit të projekteve promovuese;
- Transparenca

Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore sh.a. është ndërmarrje e re dhe në këtë pikë është duke tentuar që të ndërtoj një bazë të shendosh të transparencës dhe komunikimit. Në këtë pikë edhe gjatë vitit 2022, fokusi ynë do ishte në plotësimin e detyrimeve karshi klientëve tanë. Duke marrë parasysh kategoritë e ndryshme të konsumatorëve tanë dhe meqenëse shërbimet tona i drejtohen më shumë se një tregu, ne i kemi ndërlidhur disa detyrime bazë që mendojmë t'i mbajmë drejt secilës kategori të konsumatorëve të cilat janë: Transparenca; Korrektësia dhe Trajtimi jo diskriminues.

Sikur në ofrimin e shërbimeve në fushën e gastronomisë, ne mendojmë që gjatë këtij viti të zhvillojmë edhe më shumë angazhimet tona drejt këtyre detyrimeve, në mënyrë që konsumatorët tanë të jenë të kënaqur me ne si partner i tyre. Ndërsa, sa i përket detyrimeve tona karshi klientëve gjatë vitit 2023, do të punojmë në mënyrë që veprimtarinë tonë ta zhvillojmë duke ndikuar në ngritjen e nivelit të cilësisë së shërbimit dhe ushqimit.

KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE

Kuvendi Komunal i Prishtinës, ka bërë konstituimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve. Komisioni Komunal i Aksionareve, nga konstituimi ka mbajtur 5 takime, në të cilat është shqyrtuar dhe aprovuar kërkesa për lirimin nga detyra të ish bordit të drejtorëve të NPL Kuzhina Qendrore i dhe emërimi i anëtarëve të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve.

Komisioni Komunal i Aksionareve, po ashtu ka miratuar edhe:

- Akti Themelues
- Statutin e ndërmarrjes

Komisioni Komunal i Aksionarëve që nga kompletimi i zgjedhjes së tij ka asistuar dhe ka ndihmuar Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin në sfidat dhe obligimet e ndërmarrjes e në veçanti në ndërlidhshmërinë e obligimeve ndër institucionale të ndërmarrjes me Komunën e Prishtinës. Komisioni ka shprehur gatishmërinë të ndihmoj ndërmarrjen tonë drejtë përparimit të këtij institucioni në nivelet sa më të mira të mundshme. Angazhimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve ka qenë në prezantimin e projektit për instalimin e solareve, projekt ky i cili financiarisht ka fituar përkrahjen e Kuvendin e Komunal të Prishtinës.

BORDI I DREJTORËVE

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike, Bordi i drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kuzhina Qendrore sh. a., është në përbërje prej katër (4) drejtorëve që zgjidhen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve, ndërkohë anëtari i 5 i Bordit është Kryeshefi Ekzekutiv, i cili emërohet nga Bordi përmes procesi rekrutues. Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Drejtorët e Bordit për punën dhe përgjegjësit e tyre i raportojnë Komisioni të Aksionarëve.

Gjatë tremujorit të parë të periudhës raportuese Bordi i Drejtorëve të NPL Kuzhina Qendrore sh.a. ka mbajtur 5 mbledhje, ku janë shqyrtuar dokumente dhe procese me rendësi për ndërmarrjen. Ndër çështjet që janë miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve janë aktet e tjera si në vijim:

- Rregullore për Marrëdhënien në Punës;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës
- Organogramin e N.P.L “Kuzhina Qendrore sh.a
- Deklarata për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe
- Zyrtarëve të Ndërmarrjes;
- Vendimi për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit dhe shpenzimit për mbushje telefonike në ndërmarrje;
- Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Kuzhinës dhe QKMF-së

Në tremujorit e dytë të periudhës raportuese Bordi ka mbajtur 4 mbledhje. Bashkë me Bordin e Drejtorëve është punuar shumë në krijimin dhe plotësimin e akteve nën ligjore të ndërmarrjes dhe në këtë drejtim në periudhën raportuese janë aprovuar këto:

- Statuti i ndërmarrjes,
- Akti themeltar i ndërmarrjes,
- Rregulloren për marrëdhënie në punë
- Rregulloren për përgjegjësin disiplinore dhe materiale,
- Rregullore mbi Pagat dhe Kompensimet e tjera
- Rregullore për mirësjellje dhe Etike,
- Rregullore për trajnimin e stafit.

Ndërkohë gjatë tremujorit të tretë, në një mbledhje të mbajtur është miratuar plotësim ndryshimi i Planit të biznesit të vitit 2022. Tremujori i fundit i periudhës raportuese është karakterizuar me organizimin e 4 mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve, ku janë miratuar dokumentet ne vijim:

- Miratimi i Planit të Biznesit për vitin 2023
- Miratimi i Rregullores për Pensionim të Parakohshëm, si dhe
- Miratimi i Rregullores për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare të Kuzhinës Qendrore

KRYESHEFI

Periudha raportuese është kategorizuar me ndërrimin e menaxhmentit të ndërmarrjes. Në Janar të këtij viti është bërë dorëzim pranimi i detyrës nga ish u.d. i kryeshefit tek kryeshefi i zgjedhur. Kryeshefi i ri është zgjedhur bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike, nga Bordi i Drejtorëve, përmes një procesi të hapur konkurrues.

Në kuadër të Zyrës së Kryeshefit, sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, përfshihen Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Zyra Ligjore, Zyra e Prokurimit dhe Zyra e Auditimit.

Ndërmarrja në periudhën raportuese ka qenë e fokusuar në krijimin e kushteve për operimin në tregun jashtë Marrëveshjes në Shtëpi që e ka më Komunën e Prishtinës, e cila siguron dërgimin e shujtave të ngrohta për 16 Institucione Parashkollore dhe 500 shujta për rastet në gjendje të rëndë sociale.

Ndërmarrja ka arritur që të nënshkruaj një (1) Memorandum të Bashkëpunimit për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, për dërgimin e shujtave të ngrohta falas për personelin mjekësor dhe teknik për Qendrën e Vaksinit. Ndërmarrja në periudhën raportuese ka qenë e fokusuar në krijimin e kushteve për operimin në tregun jashtë Marrëveshjes në Shtëpi që e ka më Komunën e Prishtinës, e cila siguron dërgimin e shujtave të ngrohta për 16 Institucione Parashkollore dhe 500 shujta për rastet në gjendje të rëndë sociale.

Ndërmarrja ka insistuar në propozimin e saj që shpërndarja e shujtave të decentralizohet edhe në 3 ose 4 pika të tjera, veçmas në zonat me të thella rurale të Prishtinës, për t'iu mundësuar qytetarëve në nevojë, furnizim me të lehtë më shujta. Komuna ndonëse parimisht e përkrahë deri me tash nuk ka ndërmarr ndonjë iniciativë. Vendimi për themelimin e Komisionit për menaxhimin e procesit të rekrutimit. Ndërmarrja ka qenë përfituese edhe i një donacioni tjetër nga organizata Humanity first.

Ky donacion ka të bëjë me dhënien e 200 kg mish, qëllimi i të cili ka qenë të shpërndahet si shujtë e gatshme për familjet më gjendje të rend sociale. Ndërmarrja ka negociuar dhe parimisht është pajtuar për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi më Ndërmarrjen Publike Banesore, fryt i të cilës do të ishte intervenimet në mirëmbajtje të objekteve të NPL Kuzhina Qendrore.

Si rezultat i bashkëpunimit të mirë me Drejtorin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave të Komunës së Prishtinës, ndërmarrja ka arritur të siguroj intervenimin në përmirësimin e infrastrukturës rreth objektit të ndërmarrjes si dhe përmirësimit të rrjetit të ujëmbledhësit rreth objektit. Është plotësuar dhe ndryshuar kontrata ne shtëpi me Komunën e Prishtinë, çka i ka hapur rrugë pagesës së faturave nga ana e Komunës ndaj ndërmarrjes.

Gjatë periudhës raportuese është negociuar kontrata e re me Komunën e Prishtinës, e cila edhe është nënshkruar brenda kesaj periudhe raportuese. Kontrata e re në shtëpi më Komën e Prishtinës, ka arritur t'i reflektoj kërkesat e ndërmarrjes. Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësiive gjatë periudhës raportuese janë organizuar një serë takimesh me palët e interesit por edhe me stafin e ndërmarrjes. Takimet me stafin e ndërmarrjes kanë qenë të rregullta javore.

Ka vazhduar konsultimi me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, ku është synuar të behet riorganizimi dhe përmirësimi i kushteve të shpërndarjes se shujtave për rastet me gjendje të rend sociale. Bashkë më kryetarin e Komunës është vizituar Qendra e të moshuarve, ku është bërë shpërndarja e ushqimit për të moshuarit që janë jashtë skemave sociale, aktivitet ky i kryetarit të Komunës. Me qëllim të arritjes së objektivave, janë zhvilluar takime të rregullta pune më nënkryetarin e Komunës, Drejtorin e Administratës, Menaxhmentin e ndërmarrjes Hortikultura etj.

Edhe në këtë tremujor ka vazhduar komunikimi i rregullt me punëtorët e ndërmarrjes, duke organizuar takime të rregullta me pjesën e punëtorëve që janë të angazhuar në Institucionet Parashkollore. Takime të rregullta kemi organizuar edhe me zyrtarët e Institucioneve Parashkollore, ku janë trajtuar çështjet me interes të përbashkët.

Bashkë me Bordin e Drejtorëve është punuar shumë në krijimin dhe plotësimin e akteve nën ligjore të ndërmarrjes dhe në këtë drejtim në periudhën raportuese janë aprovuar këto:

- Rregullore për Marrëdhënien në Punës;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës
- Organogramin e N.P.L “Kuzhina Qendrore sh.a;
- Statuti i ndërmarrjes,
- Akti themeltar i ndërmarrjes,
- Rregulloren për marrëdhënie në punë
- Rregulloren për përgjegjësin disiplinore dhe materiale,
- Rregullore mbi Pagat dhe Kompensimet e tjera
- Rregullore për mirësjellje dhe Etike,
- Rregullore për trajnimin e stafit.
- Miratimi i Planit të Biznesit për vitin 2023
- Miratimi i Rregullores për Pensionim të Parakohshëm, si dhe
- Miratimi i Rregullores për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare të Kuzhinës Qendrore
- Deklarata për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Ndërmarrjes;
- Vendimi për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit dhe shpenzimit për mbushje telefonike në ndërmarrje;
- Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Kuzhinës dhe QKMF-së.
- Deklarata për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe
- Zyrtarëve të Ndërmarrjes;
- Vendimi për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit dhe shpenzimit për mbushje telefonike në ndërmarrje;
- Vendimi për komisionin ad-hoc për evidentimit e pajisjeve në magazinën e Kuzhinës,
- Vendimi për zbatimin e procedurave të pushimit ditor,
- Vendimi për krijimin e Komisionit të menysë për Institucionet Parashkollore,
- Vendimi për përgatitjen dhe publikimin e menysë për sektorin privat (shitjet ditore)
- Kërkesë për caktimin e kufijve kadastral të pronës së NPL Kuzhina Qendrore, drejtuar Komunës së Prishtinës;

- Kërkesë për zhvendosjen dhe lejen për vendosjen e laurës në oborrin e ndërmarrjes;
- Kërkesë për leje të zhvendosjes së gjeneratorit
- Vendimi për krijimin e dosjes së gjithsecilit të punësuar në ndërmarrje;
- Kërkesë për validitetin e librezave sanitare të stafit;
- Vendimi për rendin shtëpiak në Kuzhinë;
- Vendimi për sigurinë gjatë shpërndarjes së ushqimit;
- Vendimi për Transferim të një servituese nga IP Ardhmëria tek IP Buzëqeshja;
- Vendimi për Transferim të një servituese nga IP Ardhmëria tek IP Gëzimi Ynë;
- Vendimi për Transferim të një servituese nga IP Dielli tek IP Yllkat;
- Vendimi për Transferimin e dy punonjësve teknik në vendin e punës shofer/asistent shoferi;
- Kërkesë për anulimin e Konkursit Publik të shpallur me 5.11.2021;
- Vendimi për themelimin e Komisionit adhoc disiplinor;
- Vendimin për themelimin e Komisionit adhoc të ankesave për shqyrtimin e vendimit të Komisionit Disiplinor;
- Vendimi për shkurtimin e orarit të punës të një punonjëse, sipas rekomandimit të QKMP (Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës)
- Vendimi për inventarizim dhe regjistrim të pasurisë së ndërmarrjes.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Në periudhën raportuese janë përgatitur projekt kapitale që do të ndikojnë në rritjen e produktivitetit të ndërmarrjes, siç është projekti për riorganizimin e kuzhinës, projekt ky që me të filluar se zbatuari do të ndaj kuzhinën në dy sektor, në sektorin për fëmije dhe në sektorin për shërbimin për qytetar (sektori privat). Ndërmarrja në konsultim të ngushtë me Institucionet parashkollëre publike dhe ato në bazë në komunitet, pasi që ka aprovuar menynë e re për fëmijët e këtyre institucioneve i ka bërë të gjitha përgatitjet që kjo meny të fillojë se zbatuari nga muaji shtator 2022. Në menynë e re kemi pasur për qëllim të krijojmë meny 4 – javore, si dhe të ndryshojmë frutat dhe perimet në bazë të stinës (pranverë – vërë dhe vjeshtë dimër). Të pasurojmë menynë me produkte të reja ushqimore, përfshirë llojllojshmëri të drithërave, frutave dhe perimeve dhe të shtojmë peshkun një herë brenda katër javësh. Të zëvendësojmë ushqimet me sasi të lartë të sheqerit të shtuar, me alternativa më të shëndetshme si dhe të krijojmë normativë të re për sasinë e kripës për fëmije. Të rrisim sasinë dhe të kombinojmë dy apo tri ushqime gjatë mes vaktit, në mënyre që t'i mbajë fëmijët më të ngopur.

Departamenti i Administratës në periudhën raportuese ka kryer aktivitetet e planifikuara me plan të punës. Gjatë kësaj periudhë, në bazë të aplikimit të bërë me dt. 17.06.2022 në projektin e Agjencisë “KIESA” mbi ndërmarrje publike, kemi mundur praktikën për dy praktikante të

cilat kanë ndjekur punën praktike në ndërmarrje nga dt. 01.10.2022 deri me 31.12.2022.

Në këtë rast N.P.L “Kuzhina Qendrore” sh.a. është vlerësuar me mirënjohje nga agjencia KIESA për mundësinë e krijuar për praktikantët e reja, që të përfundojnë praktikën profesionale në cilësinë e studentit. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar procedura rekrutuese në bazë të akteve normative në fuqi. Gjatë këtij procesi kanë aplikuar 98 persona në 21 pozita të shpallura në konkursin publik, nga ky numër 64 persona janë kualifikuar në testin me shkrim, kurse nga ta vetëm 36 persona kanë plotësuar kushtet për intervistën me gojë, kurse vlen të theksohet se në intervistë kanë marrë pjesë 33 persona.

DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT DHE DISTRIBUIMIT


Departamenti i Furnizimi dhe Distribrimi është departament i ri i themeluar me miratimin e Rregullores së Brendshme. Si tërësi është funksionalizuar në fund të vitit, megjithatë, detyrat dhe përgjegjësit gjatë gjithë periudhës raportuese janë kryer sic e kërkojnë aktet ligjore dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur furnizimet e bëra gjatë vitit 2022 nga Ndërmarrja Kuzhina Qendrore. Vlera mesatare mujore e furnizimet ka qene 38,000 euro. Pikat të cilat paraqiten në fund të kurbës janë në vlera të ulëta meqë nënshkrimi i kontratave për furnizim ka ndodhur në muajt Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2022.

Ndërmarrja ka nevojë për furnizime të llojeve të ndryshme. Ato me kryesoret i veçojmë në furnizime për pemë dhe perime, për mish, për bulmet dhe brumëra. Ne te njëjtën kohë, me shtimin e kërkesës për porosi nga sektori privat, Kuzhina është obliguar në iniciimin e procedurave te reja për paketime ushqimore dhe produktet ushqimore të pa përfshira me herët ne listën e produkteve.

Nga Grafikoni më poshtë mund të shohim që vlera me e lartë e furnizimeve ka ndodhur për bylmet, peme dhe perime si dhe mish.


FURNIZIMET NGA OPERATORËT PRIVAT



Kurba lineare e cila tregon shpërndarjen mesatare të shujtave në tri target grupet e Kuzhinës, ka një trend pozitiv gjate gjithë vitit. Pika më e ulët e kurbes ka ndodhur në muajin Shtator, kjo si rezultat i grevës tek sektori i arsimit për dy muaj. Si rrjedhojë e kësaj numri i shujtave ka rënë se bashku me të hyrat për këta muaj, e cila pasqyrohet me poshtë në grafikonin e të hyrave mesatare.

Pikun e shpërndarjes ndërmarrja e ka realizuar në muajt Qershor dhe Dhjetor. Kjo për dy arsye, programet festive në dy periudha të vitit tek Institucionet Parashkollor si dhe promovimi i menysë se re në sektorin privat.

DISTRIBUIMI TEK IP, QS DHE SEKTORI PRIVAT



DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Kuzhina gjatë vitit 2022 ka blerë pajisje të reja për të plotësuar nevojat e operimit afarist. Në të njëjtën kohe ndërmarrja ka përdorur pajisje të blera për nevojat e Kuzhinës në vitin 2018 e cilat janë zhvlerësuar. Gjithashtu në pronësi të Komunës së Prishtinës janë edhe tri vetura për bartjen e ushqimit me vit të prodhimit 2015, kurse në fund të vitit 2022 Kuzhina Qendrore ka blerë një veturë të re në vlerë 19,850 euro.

Gjithashtu gjatë këtij viti ndërmarrja është kujdesur për kryerjen e të gjitha obligimeve financiare ndaj operatorëve furnizues. Ndërsa portolio kreditor në banka afariste ndërmarrja nuk ka.

Në fund të vitit Komuna e Prishtinës i ka dhuruar një subvencion në vlerë 30,000 euro Kuzhinës Qendrore për instalimin e Solareve të planifikuara për vitin 2023.

TË HYRAT, LLOJET E TYRE DHE SHPENZIMET E KATEGORIZUARA.

Të hyrat që ndërmarrja ka realizuar janë nga shitja tek Institucionet Parashkollore, tek Qendrat Sociale si dhe shitjet në sektorin privat.

Tab: Të hyrat, llojet e tyre dhe shpenzimet e kategorizuara

Totali i të hyrave reale	591,856.66
Kosto e shitjes	
Kosto e shitjes se mallrave KMSH	74,195
Shpenzimet totale Shpenzimet operuese	432,097.73
Shpenzimet për paga	391,823.88
Shpenzimet e internetit	203.4
Shpenzimet e sigurimit te automjeteve	191.16
Shpenzimet e ngritjes profesionale- Trajnime	195
Shpenzimet e konkursit	889.84
Shpenzimet e telefonit	1,475.17
Shpenzimet e zhvlersimit dhe amortizimit	5,219
Shpenzime te zyres	5,149.88
Shpenzime të derivateve	5,778.61
Komunalite(rryme-uje)	10,338.39
Shpenzime tjera	10,563.40
Shpenzime për provizion bankar	269.14
Fitmi /Humbja	85,563
Shpenzimet e tatimit në fitim	(8,556)
Fitimi apo humbja e vitit	77,007

Të hyrat nga shitja e mallrave:

Këtu përfshihet faturimi, i cili bëhet për ofrimin e ushqimit tek Institucionet Parashkollore dhe Qendrat Sociale, në Komunën e Prishtinës. Gjatë vitit 2022 vlera e këtyre shërbimeve është 1,027,591.50 euro. Sipas Kontratës në Shtëpi, ndërmjet Kuzhinës Qendrore dhe Komunës së Prishtinës, deri më datë 11.11.2022 çmimi i shujtave ishte 1.5 euro, pas kësaj date çmimi për shujtë u bë 2.00 euro, pas arsyetimit të faktuar për kosto për njësi. Gjithashtu me kontratën e vjetër, Komuna ka marr përsipër pagesën e furnizimeve për lëndë të parë nga operatorët privat, andaj vlera faturuar mujore është zbritur me shumen e furnizimeve.

Kosto e mallrave të shitura (1), Zbritjet nga komuna:

Vlera e furnizimeve të cilat Komuna e Prishtinës i ka zbritur nga faturimi për vitin 2022 është 388,300.48 euro. Llojet e këtyre furnizimeve janë për: produkte ushqimore, brumëra, bulimet, peme dhe perime, mish.


Andaj të hyrat reale të Kuzhinës Qendrore, të cilat janë pranuar përmes transfereve bankare janë 568,528.54 euro për vitin 2022. Kjo është shuma me të cilën Kuzhina Qendrore ka operuar për të mbuluar koston e furnizimeve tjera, shpenzimeve për paga dhe shpenzimet tjera operative.

Krahas të hyrave për ofrimin e shujtave tek Institucionet Parashkollore dhe Qendrat Sociale, Kuzhina Qendrore, nga mesi i vitit 2022, ka testuar ofrimin e shërbimeve edhe tek operatorët privat.

Të hyrat nga aktiviteti privat

Vlera e këtij shërbimi ka arritur në 23,325.23 euro në vitin 2022. Kërkesa për shërbimet e Kuzhinës Qendrore, është shtuar në mënyre signifikante nga ana e sektorit privat. **Shuma totale e të hyrave reale** për vitin 2022 për Kuzhinën Qendrore është 591,856 euro (Të hyrat nga IP dhe QS- minus furnizimet dhe të hyrat nga aktiviteti privat)

Kontrata në Shtëpi, parashihte mbulimin e furnizimeve nga ana e Komunës së Prishtinës, deri në përfundimin e Kontratave me Autoritetin Qendror të Prokurimit në Kosovë. Nga Qershori i vitit 2022, Kuzhina Qendrore është detyruar të hap procedura për furnizim me lëndë të parë, meqë kanë filluar të skadojnë kontratat e furnizimeve të mëparshme.



RAPORTI I SHITJEVE MUJORE 2022

Në Institucione Parashkollore dhe Qendra Sociale

Në sektorin Privat

Kosto e shitjes se mallrave - (2)


Vlera e këtyre furnizimeve, të cilat i ka paguar Kuzhina Qendrore është 63,527.52 euro për vitin 2022. Vlera reale për koston e shitjes se mallrave të cilat përfshijnë ato që i ka paguar Komuna e Prishtinës, se bashku me Kuzhinën Qendrore është 451,828.00 euro. Ne pasqyre te ardhurave për vitin 2022 KMSH e kalkuluar me matjen e stokut fillestar, blerjet dhe stokun përmbyllës vlera e KMSH është 74,195 euro.

Përveç koston direkte, e cila lidhet me prodhimin, Kuzhina Qendrore për të realizuar veprimtarinë biznesore ka krijuar kosto operative. Totali i këtyre shpenzimeve operuese është 432,097 euro për vitin 2022.

Shpenzimet për paga në vitin 2022 përfshijnë pagat bruto dhe 5% e punëdhënësit që paraqet koston e ndërmarrjes. Vlera e këtyre shpenzimeve është 391,823.88 euro.


Shpenzimet tjera të cilat marrin përqindje të lartë në totalin e shpenzimeve janë ato të derivateve. Vlera e tyre është 5,778.61 euro.

Ndërmarrja gjatë këtij viti ka realizuar edhe disa investime si renovime të zyrës, veshje me mure, instalim të kamerave dhe sistemit të kartelave identifikuese, blerje të inventarit, kompjuterëve printerëve ups, imporvizim të gardërobës, shtim i strehës, servisim i gjeneratorit, blerja e pajisjeve për evidentimit e stokut, blerja e programit të kontabilitetit dhe se fundi në dhjetor blerja e një automjeti.



Shpenzimet e komunalive kanë arritur në 10,338.39 euro. Për të rekrutuar punëtorë të rinj shpenzimet e publikimit në gazeta kanë arritur në 889.84 euro. Në vitin 2022 ndërmarrja ka publikuar 3 llojë të konkurseve. Ku të punësuarit me konkursin e fundit fillojnë punën në vitin 2023.


RAPORTI I FITIMIT MUJOR 2022



Fitimi i ndërmarrjes është llogaritur duke zbritur totalin e shpenzimeve nga totalin e të hyrave reale, që për këtë vit është 77,077 euro.

Ndërmarrja ka synuar t'i realizojë projektet e parapara në Planin e Biznesit për vitin 2022, duke u siguruar gjithashtu që të ketë likuiditet për shpenzimet e pagave të paktën për një muaj pasues. Kjo si mësim i dal nga Janari i vitit 2022, ku për shkak të bllokimit të buxhetit shtetëror, është pamundësuar transferi i pagesave të faturave nga ana e Komunës së Prishtinës. Me crast pagat e punëtorëve janë vonuar si dhe është aplikuar ndëshkim me interes nga ATK, për mos pagese të obligimeve tatimore nga ana e ndërmarrjes. Për të evituar këtë skenar, jemi munduar të ndajmë fonde mujore dhe sigurojmë likuiditet edhe për punëtorët e rinj që fillojnë punën nga shkurti i vitit 2023

RAPORTI PERIODIK I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE 2022



SHPENZIMET KAPITALE

Sipas kërkesave të Departamenteve të ndërmarrjes shpenzimet kapitale të cilat u realizuan në vitin 2022 janë si në vijim:

Plani detal i shpenzimeve kapitale	Vlera
Furnizim me vetura	19,987.80 euro
Instalimi Laurës automatike	1,530 euro
Furnizim dhe montim i veshjeve te mureve për zyre	4,400 euro
Servisimi i gjeneratorit	3,50 euro
Furnizim dhe montim i strehës	2,448 euro
Furnizim dhe mirëmbajta e ndriçimit publik	595 euro
Furnizim me pajisje te reja për nevojat e KQ	6,552.94 euro
Furnizim me pajise te teknologjisë informativë	7,880 euro
Furnizim me lexues barkodi dhe printer për etiketa	855 euro
Furnizim dhe instalim i kamerave	968.65 euro
Furnizim dhe instalim i sistemit të menaxhimit të hyrje-daljeve	350 euro
Furnizim dhe montim i dyerve	3558.60 euro
Furnizim me pajisje te teknologjisë informative	1,660 euro
Furnizim me program të kontabilitetit	944 euro
Krijim, dizajnimi dhe mirëmbajta e ueb faqes	977 euro
Furnizim me printer fiskal	670 euro
Totali i shpenzimeve	56,876.99 euro

Kategoria e projekteve të realizuara përfshinë disa fusha: investime afatgjata të cilat kanë rezultat në ngritjen e mirëqenies shoqërore dhe zvogëlimin e impaktit negativ në mjedis; investime të cilat lidhen direkt me lehtësimin e procesit të punës, si blerja dhe mirëmbajtja e pajisjeve të reja të punës; investime që në qendër kanë mbrojtjen dhe shëndetin e punëtorit; dhe kategoria e fundit, investimet të papritura si rezultat i forcës madhore të cilat financohen nga një fond i kapitalit të mbajtur mujor.

Për shkak të natyrës së punës, disa prej investimeve apo shpenzimeve ndahen në periudha të ndryshme të vitit. Servisimi, mirëmbajtja, furnizimi me lënde të parë, krijon kosto në relacion të drejtë me kërkesën.

DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vetw pjesën e përgatitjes së ushqimit. Departamenti në vete ka 7 kuzhinier në angazhim. Sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës ish Operativa është shndërruar në Departament të Prodhimit, që përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë periudhës raportuese, Departamenti ka arritur të përgatisë 140 mijë shujta për Institucionet Parashkollore dhe Qendrat Sociale, si dhe 2128 shujta për Qendrën e Vaksinit, në periudhën e parë të vitit. Në tre mujorin e dytë të vitit 2022 janë prodhuar 173 mijë shujta për Institucionet Parashkollore dhe Qendrat Sociale, si dhe 521 shujta për sektorin privat. Kurse nga muaji korriku deri në shtator janë prodhuar 116449 shujta për IP dhe 4600 shujta për sektorin privat. Viti 2022 është përmbyllur me prodhimin e gjithsej 625,431 shujta nga Kuzhina Qendrore.

Gjatë periudhës raportuese departamenti ka qenë i fokusuar në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit. Pjesë e veçantë e angazhimit të këtij departamenti ka qenë përgatitja e shujtave shtesë për personelin mjekësor dhe teknik për Qendrën e Vaksinit në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Përveç punëve dhe detyrave të përcaktuara, Departamenti ka kryer edhe punët e Departamentit të Furnizimit dhe Distributimit, meqë ky departament në pjesën e parë të vitit ka qenë në themelimin e sipër. Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në institucionet e IP, si dhe përgatitjen e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik.

Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës. Është kujdesur dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me Departamentin e Arsimit për ekzekutimin e pagesës së faturave si dhe në të njëjtën kohë ka mbajtur kontakt me të gjitha Institucionet Parashkollore për tu kujdesur për mbarëvajtjen e procesit të përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit.

NGRITJA E KAPACITETEVE TË NDËRMARRJES

Ndërmarrja është në proces të ristrukturimit nga një entitet që ka punuar në kuadër të Komunës së Prishtinës, në një entitet të pavarur bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si ndërmarrje publike. Ndërmarrja ka trashëguar një staf, ku shumica prej tyre kanë përgatitje të mesme shkollore. Përveç kësaj stafi është në moshë të shtyrë. Ndërmarrja po ashtu ka trashëguar një listë të punëtorëve që kanë qenë të angazhuar nga Komuna e Prishtinës për një periudhë mbi tre vjeçare me kontratë për punë dhe detyra specifike. Në bashkëpunim me Oden Ekonomike Gjermani kemi punuar për angazhimin për një periudhë të caktuar kohore të ekspertëve të kulinarisë, që do të mund të zhvillonin trajnime në vendin e punës për stafin e Kuzhinës Qendrore. Në tremujorin e parë është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri. Kemi angazhuar ekspert për të vlerësuar kapacitetin prodhues dhe jetëgjatësinë e pajisjeve të instaluar në Kuzhinë. Gjatë muajit Mars është bërë vlerësimi, ndërkohë në Prill presim raportin që është një përshkrim se si të veprohet në muajt në vijim.

INFORMIMI DHE AVOKIMI

Ndërmarrje në periudhën raportuese ka rritur prezencën e saj në mediat duke pasqyruar kështu gjithë punën që po bëhet nga stafi në tërësi për forcimin e ndërmarrjes por edhe të shërbimit.

Në periudhën raportuese është arritur që të funksionalizohet faqja e ndërmarrjes në rrjetin social Facebook dhe njëkohësisht edhe të pasurohet më informata.

Është dizajnuar, punuar dhe funksionalizuar ueb faqja e ndërmarrjes, që është një dritare e mirë e komunikimit me opinionin. Ueb faqja është pasuruar me dokumentet e nevojshme ekzistuese të ndërmarrjes si dhe ofron një qasje të lehtë për të interesuarit deri tek informata e kërkuar.

Tendenca e jonë është që të forcojmë këtë sektor dhe njëkohësisht ta lehtësojmë qasjen deri tek informata.

Fund!